

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: E drejta në jetë

1. Secili individ gëzon të drejtën për jetën.

Constitutional Paragraph: Neni 25 para. 2

2. Dënimi me vdekje është i ndaluar.

Instrumentet ndërkombëtare	Nenet
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike	Article 6.1 E drejta e jetës është e drejtë e lindur e njeriut. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta.
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike	Article 6.2 2. Në vendet ku nuk është hequr dënimi me vdekje, ai mund të jepet vetëm për krimet më të rënda, në përputhje me ligjin në fuqi në kohën e kryerjes së krimit dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me dispozitat e këtij Pakti dhe me Konventën për Parandalimin dhe Ndjekjen e Krimit të Gjenocidit. Ky dënim mund të jepet vetëm në bazë të një gjykimi përfundimtar nga një gjykatë kompetente.
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike	Article 6.3 3. Kur heqja e jetës përbën një krim gjenocidi, kuptohet se asnjë dispozitë e këtij neni nuk i jep të drejtë një shteti palë të këtij Pakti që në asnjë mënyrë t'i shmanget çfarëdo detyrimi që ka marrë për sipër në bazë të dispozitave të Konventës për Parandalimin dhe Ndjekjen e Krimit të Gjenocidit.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 6.4

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

4. Çdo individ me vdekje ka të drejtë të kërkojë falje ose zëvendësim të dënimit. Amnistia, falja ose zëvendësimi i dënimit me vdekje mund të jepen në të gjitha rastet.

Article 6.5

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

5. Dënimi me vdekje nuk mund të jepet për krimet e kryera nga personat nën 18 vjeç dhe nuk mund të zbatohet ndaj grave shtatzëna.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

Neni 2 .1

E drejta për jetën

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

Neni 2.2

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

a. në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;

b. për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht; c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 3

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Gjithkush ka të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personalitetit.

Neni 6

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Neni 6

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

1. Shtetet palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e lindur për të jetuar.

2. Shtetet palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 37

(a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtuese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepen për shkelje të ligjit të kryera nga persona nën 18 vjeç;

(b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për një kohë të përshtatshme sa më të shkurtër.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës
Konventa për të Drejtat e Fëmijës

(c) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të lindur të njeriut dhe në mënyrën e cila merr parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, përveç në rrethana të jashtëzakonshme;

(ç) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të sfidojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të pashprehur si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Ligjet

KODI NR. 06/L-074 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Nenet

Neni 172

Vrasja

1. Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 173

Vrasja e rëndë

KODI NR. 06/L-074 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:

1.10. privon nga jeta personin tjetër motivuar në bazë të kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërin nga këto karakteristika të mbrojtura;[...]

Ligjet

KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Nenet

Neni 174

Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore

1. Kushdo që personin tjetër e privon nga jeta në gjendje të tronditjes së fortë mendore, të shkaktuar pa fajin e tij nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 175

Vrasja nga pakujdesia

1. Kushdo që e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 176

1. Vrasja e foshnjës gjatë lindjes Nëna që e privon nga jeta foshnjën e vet gjatë lindjes apo menjëherë pas lindjes, derisa te ajo vazhdon çrregullimi i shkaktuar nga lindja, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 4

Sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm

1. Sanksionet penale janë:

1.1. dënimet kryesore;

1.2. dënimet alternative;

1.3. dënimet plotësuese; dhe

1.4. vërejtja gjyqësore.

2. Masat e trajtimit të detyrueshëm, të cilat mund t'i shqiptohen kryesit që nuk është penalisht i përgjegjshëm ose është i varur nga droga, ose nga alkooli, janë:

2.1. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;

2.2. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe

2.3. trajtimi me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga apo alkooli

decisionTitle*

decisionDescription*

Kërkesa për Perisan dhe të tjerët kundër Turqisë nr. 12336/03 e 20.05.2010

Perisan and Others v.
Turkey application no.
12336/03 of 20.05.2010

Shkelja e nenit 2: forca e përdorur kundër të burgosurve për të shuar shqetësimet në një burg, që kishte çuar në vdekjen e tetë prej tyre, nuk kishte qenë "absolutisht e domosdoshme" brenda kuptimit të nenit 2 dhe **Gjykata konstatoi se kishte pasur një shkelje të nenit 2** në lidhje me tetë të burgosurit që kanë vdekur dhe gjashtë që kanë mbijetuar lëndimet e tyre.

Wasilewska and Kalucka v. Poland 23.02.2010 application no. 28975/04 and 33406/04

Wasilewska and Kalucka
v. Poland 23.02.2010
application no. 28975/04
and 33406/04

The case concerned the death of a suspect during an anti-terrorist operation.
Violation of Article 2: the Polish Government had failed to submit any comments regarding the proportionality of the level of force used by the police, the organisation of the police action and whether an adequate legislative and administrative framework had been put in place to safeguard people against arbitrariness and abuse of force.